**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644-24-8752-1-3-6/C952**
**14 Nr. 813/24**
**Dt. 30.09.2024**

# KONTRATË FURNIZIMI

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi– Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI)** , dhe

2. **" HPI " SH.P.K., Prishtinë,** me seli në**Prishtinë,** me **ARBK : 810153750**, të cilën e përfaqëson **z. Arianit Morina**, në tekstin e mëtejmë: **FURNIZUESI ,**

, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi me paisje për praktikë profesionale për drejtimin e zdrukthtarisë në SHMT "Lutfi Musiqi".**, me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i prokurimit** | **VU644** | **2** | **4** | **87** | **5** | **2** | **1** | **3** | **6** |
| **Nr. iibrendshëm** | **VU644** | **2** | **4** | **0** | **7** | **8** | **1** | **3** | **6** |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi me paisje për praktikë profesionale për drejtimin e zdrukthtarisë në SHMT "Lutfi Musiqi"., në pajtim me Specifikat Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: **jo më gjatë se 30 ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit të kontratës.**

1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **SHMT Lutfi Musiqi - Vushtrri, në pajtim me Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate.**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[1] (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

[1] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **8,932.00 € ( tetëmijëenëntqindetridhjetedy/00 Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës **pasi që Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues dhe Komisioni i Pranimit të mallit të A.K. të konfirmoi me shkrim pranim- dorëzimin e aparateve, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se pajisjet janë dorëzuar – pranuar nga personat kompetent në institucionin në fjalë, si në aspektin sasior ashtu dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të Mallit do ti dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfunduara.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i **furnizimeve dhe / ose shërbimeve** është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisjet e dorëzuara duhet, në të gjitha aspektet, ti plotësojnë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit. **Kontraktuesi duhet të dorëzoi Deklaratën me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur për garancionin e kualiteti e kontratës për periudhën e kohëzgjatjes prej 12 muaj nga data e dorëzimit të mallit.**

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj *kompensimeve* tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **furnizimeve dhe / ose shërbimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet **në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.**

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhen **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik:**

**" HPI " SH.P.K.– Prishtinë**

**Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë**

| **Emri:** | **Arianit Morina** | **Emri:** | **Ilmi Azemi** |
|---|---|---|---|
| Pozita: | Drejtor | Pozita: | Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | 30.09.2023 | Data: | 30.09.2023 |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 18%,~~ Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore**

**Furnizimi me paisje për praktikë profesionale për drejtimin e zdrukthtarisë në SHMT "Lutfi Musiqi"**

| Nr. | Përshkrimi i pozicioneve | Njësia Matëse | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH | Totali (me TVSH)-€ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **I** | **Furnizimi me paisje per praktik profesionale per drejtimin e zdrukthtarise SHMT "Lutfi Mu** | | | | | | | | |
| 1 | **KGS 216 M SHARRË kendore me terhjekje**<br>Te dhenat teknike<br>Dimensionet 710 x 476 x 512 mm<br>Sipërfaqja mbështetëse345 x 730 mm<br>Gjerësia maksimale e prerjes 90°/45°305 / 215 mm<br>Thellësia maksimale e prerjes në 90°/45°70 / 40 mm<br>Kapaciteti i prerjes 90°/90°305 x 70 mm<br>Kapaciteti i prerjes 45°/45°215 x 40 mm<br>Vendosja e rrotullës majtas/djathtas 50/50 °<br>Tehu i sharrës anohet majtas/djathtas 47/2 °<br>Teh i sharrës 216 x 30 mm // 8 1/2 x 1,181 "<br>Fuqia e vlerësuar e hyrjes 1200 W<br>Fuqia e vlerësuar e hyrjes S1 100%1200 W<br>Fuqia e vlerësuar e hyrjes S6 20%1500 W<br>Shpejtësia pa ngarkesë 5000 rpm<br>Shpejtësia në ngarkesën e vlerësuar 3750 rpm<br>Shpejtësia e prerjes 57 m/s<br>Pesha 13,4 kg<br>Gjatësia e kabllit 2 m | cope | 1 | 296.61 | 18.00 | 350.00 € | 296.61 | 53.39 | **350.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **SXE 3150 (600444000) LËMUES ORBITAL**<br>Te dhenat teknike<br>Diametri i jastëkut mbështetës 150 mm<br>Fuqia e vlerësuar e hyrjes 310 W<br>Shpejtësia pa ngarkesë 4000 - 12000 rpm<br>Frekuenca orbitale pa ngarkesë 8000 - 24000 opm<br>Diametri i orbitës 3 mm<br>Pesha (pa kabllo elektrike) 1,6 kg<br>Gjatësia e kabllit 4 m<br>LETRA rrumbullake per zmeriluese 50 cope | cope | 1 | 160.17 | **18.00** | **189.00 €** | 160.17 | 28.83 | **189.00** |
| 5 | **Ratifikuese W 13-125 QUICK (220-240 V / 50 - 60 HZ); KUTI KARTONI**<br>Te dhenat teknike<br>Disku-Ø 125 mm<br>Fuqia e vlerësuar e hyrjes 1350 W<br>Shpejtësia pa ngarkesë 11000 rpm<br>Çift rrotullues 3,4 Nm<br>Fije boshti M 14<br>Perimetri i dorezës 206 mm<br>Pesha (pa kabllo elektrike) 2,4 kg<br>Gjatësia e kabllit 4 m | cope | 1 | 118.64 | **18.00** | **140.00 €** | 118.64 | 21.36 | **140.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | **SET BS 18 L Aku burmashine me set veglash**<br>Të dhënat teknike<br>Lloji i paketës së baterisëLiPOWER<br>Tensioni i baterisë18 V<br>Kapaciteti i paketës së baterisë 2 x 2 Ah<br>Çift rrotullues maksimal, i butë25 Nm<br>Çift rrotullues maksimal, i fortë50 Nm<br>Çift rrotullues i rregullueshëm1,5 - 6 Nm<br>Shpimi Ø çeliku 10 mm<br>Shpimi-Ø dru i butë 20 mm<br>Shpejtësitë pa ngarkesë0 - 450 / 0 - 1800 rpm<br>Kapaciteti i çakut1,5 - 13 mm<br>Pesha pa bateri1,3 kg<br>Pesha me paketën e baterive1,6 kg | cope | 1 | 139.83 | 18.00 | 165.00 € | 139.83 | 25.17 | 165.00 |
| 9 | **800-2 Burmashine elektrike me aksesore**<br>Të dhënat teknike<br>Fuqia e vlerësuar e hyrjes800 W<br>Drill-Ø murature 20 mm<br>Shpimi -Ø beton i18 mm<br>Shpimi Ø çeliku 13<br>Shpimi -Ø dru i butë 40 / 25 mm<br>Shpejtësia pa ngarkesë0 - 1200 / 0 - 3200 rpm<br>Shpejtësia në ngarkesën e vlerësuar850 / 2200 rpm<br>Shkalla maksimale e ndikimit51200 bpm<br>Ingranazhet 2<br>Kapaciteti i çaku t1,5 - 13 mm<br>Diametri i jakës 43 mm<br>Stërvitni boshtin me prerje gjashtëkëndore 6,35 mm<br>Stërvitni fijen e gishtit1/2 " - 20 UNF<br>Pesha (pa kabllo elektrike)2.3<br>Gjatësia e kabllit4.1<br>Burgiat druri diameter: 8 mm for Ø 15 - 20 - 25 mm, 10 mm for Ø 30 - 35 mm<br><br>KOMPLET SHARRE ME VRIMA DRURI Ø25-68MM, 8 COPË (623531000) | cope | 1 | 186.44 | 18.00 | 220.00 € | 186.44 | 33.56 | 220.00 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | **HBS 261-2 Sharre Shiritore verticale**<br>Të dhënat teknike<br>Gjatësia përafërsisht 680 mm<br>Gjerësia/thellësia përafërsisht 520 mm<br>Lartësia përafërsisht 1435 mm<br>Pesha përafërsisht 34 kg<br>Diametri i hundës thithëse 100 mm<br>tavolina(t) pune<br>Gjatësia 360 mm<br>Gjerësia 320 mm<br>Lartësia 935 mm<br>Pjerrësia 0 – 45°<br>Të dhënat elektrike<br>Fuqia dalëse 0.22 kW<br>Tensioni i lidhjes 230 V<br>Frekuenca e rrjetit 50 Hz<br>teh sharre me shirit<br>Shpejtësia(t) 400 / 800 m/min<br>Gjatësia 1826 mm Gjerësia 10.0 mm Trashësia 0.35 mm<br>Lartësia maksimale e prerjes 90° 152 mm<br>Lartësia maksimale e prerjes 45° 95 mm<br>Gjerësia maksimale e prerjes me ndalesë 145 mm<br>Gjerësia maksimale e prerjes pa ndalesë 245 mm<br>Sharra duhet te permbaje edhe 5 teha rezerve | cope | 1 | 610.17 | **18.00** | **720.00 €** | 610.17 | 109.83 | **720.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | **Set GIDORE 172 copë**<br>prej çeliku krom vanadium<br>fushëveprimi i dorëzimit: 7 çelësa të tipit L, gjashtëkëndësh i brendshëm 1.2 - 5 mm<br>Makinë 12,5 mm (1/2"): arpion i kthyeshëm, shufër zgjatuese katrore e jashtme/brenda 12,5 mm (1/2"), gjatësia 125 mm, shiriti zgjatues i jashtëm/katror i brendshëm 12,5 mm (1/2"), gjatësia 250 mm , përshtatës doreze rrëshqitëse, nyje universale e jashtme/brendeshme katrore 12.5 mm (1/2"), prizë kandele, 16 - 21 mm, përshtatës 12.5 mm (1/2") - 8 mm (5/16"), 17 priza , 10 - 32 mm, 5 priza të thella, 16 - 17 - 18 - 19 - 22 mm, 2 priza, E-tipi E20 - E24<br>Makinë 10 mm (3/8"): arpion i kthyeshëm, shirit zgjatues, katror i jashtëm/brendshëm 10 mm (3/8"), gjatësi 125 mm, nyje universale, katror i jashtëm/ i brendshëm 10 mm (3/8"), shkëndijë prizë 18 mm, përshtatës 10 mm (3/8") - 8 mm (5/16"), 10 priza, 10 - 11 - 12 - 13 - 14 - 15 - 16 - 17 - 18 - 19 mm, 6 të thella priza, 10 - 11 - 12 - 13 - 14 - 15 mm , 6 priza, E-lloj E10 - E11 - E12 - E14 - E16 - E18<br>Makinë 6.3 mm (1/4"): arpion i kthyeshëm, dorezë rrëshqitëse, nyje universale, katror i jashtëm/brendshëm 6.3 mm (1/4"), shirit zgjatues, katror i jashtëm/i brendshëm 6.3 mm (1/4"), gjatësi 50 mm, shirit zgjatues, katror i jashtëm/i brendshëm 6,3 mm (1/4"), gjatësia 100 mm, dorezë rrotulluese, 13 priza, 4 - 4,5 - 5 - 5,5 - 6 - 7 - 8 - 9 - 10 - 11 - 12 - 13 - 14 mm, 7 priza të thella, 4 - 5 - 6 - 7 - 8 - 9 - 10 mm, 5 priza, E-lloj E4 - E5 - E6 - E7 - E8, priza 30 bit, 1 bit përshtatës, 20 bit ,Disk 8 mm (5/16"): 24 bit<br>Mbarimi i sipërfaqes: i veshur me krom saten<br>profili: Super Lock | cope | 1 | 227.97 | **18.00** | 269.00 € | 227.97 | 41.03 | **269.00** |
| 15 | **Komplet kaçavidash 12 cop**<br>Teh i vazhdueshëm me gjashtëkëndësh të jashtëm<br>me dorezë të butë ergonomike<br>Kaqavida minus : 3,2 x 75 mm - 5,0 x 75 mm - 6,0 x 100 mm<br>- 6,0 x 38 mm - 8,0 x 150 mm - 9,5 x 200 mm<br>Kaçavida Plus: PH0 x 75 mm - PH1 x 75 mm - PH2 x 100 mm –<br>PH2 x 38 mm - PH3 x 150 mm - PH4 x 200 mm | cope | 1 | 42.37 | **18.00** | 50.00 € | 42.37 | 7.63 | **50.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | **Zmerilues I drurit**<br>Voltazhi ne hyrje 200 W Rrotullimet ne minute 15.000 - 22.000 min-1 Kendi i levizjes (L/R) 1,6 ° Përmasat (G x G x L) 283 x 68 x 98 mm Pesha (EPTA) 1,2 kg Zhurma (presioni i tingullit/fuqia e tingullit) Vibrimi 78/- dB(A) 9,5 m/s2 | cope | 2 | 42.37 | **18.00** | 50.00 € | 84.75 | 15.25 | **100.00** |
| 22 | Sharre dore per sharritjen e drurit,çelik 500mm | cope | 3 | 21.19 | **18.00** | 25.00 € | 63.56 | 11.44 | **75.00** |
| 23 | Matës nonius sqepor për matje të gjatësisë | copë | 12 | 12.71 | **18.00** | 15.00 € | 152.54 | 27.46 | **180.00** |
| 24 | Matës nonius sqepor për matje të thellësisë | copë | 5 | 16.95 | **18.00** | 20.00 € | 84.75 | 15.25 | **100.00** |
| 25 | Mikrometër me shkallë kryesore matëse dhe me shkallë rrotulluese (50mm-100mm) | copë | 4 | 50.85 | **18.00** | 60.00 € | 203.39 | 36.61 | **240.00** |
| 26 | Testues i rrymave në sig. automatike, çelesa RCD (FID) dhe matjes së rezistencës së lakut. | copë | 1 | 42.37 | **18.00** | 50.00 € | 42.37 | 7.63 | **50.00** |
| 27 | Instrument për matjen e rezistencaave të tokëzimit dhe rrufepritësit | copë | 1 | 42.37 | **18.00** | 50.00 € | 42.37 | 7.63 | **50.00** |
| 28 | Set i limave për përpunim të drurit | copë | 5 | 80.51 | **18.00** | 95.00 € | 402.54 | 72.46 | **475.00** |
| **TOTALI I PËRGJITHSHEM ME TVSH:** | | | | | | | **7,569.49** | **1,362.51** | **8,932.00** |

| **IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)** | |
|---|---|
| **EMRI I OE:** | "HPI" SH.P.K. |
| **EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:** | Arianit Morina |
| **NËNSHKRIMI:** | |
| **DATA:** | 06.09.2024 |
| **VULA:** | |

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
hpi